VENDIM
Nr.13, datë 5.3.2007

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT UNIK TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA HEC-ET E RINJ, ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW, TË DHËNË ME KONCESION

Në mbështetje të neneve 26 pika 1 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve" kreu IV pika 1"a" të këtyre rregullave dhe nenit 11 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.3.2007, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve për metodën e përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj, me fuqi të instaluar deri në 10 MW,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj, me fuqi të instaluar deri më 10 MW, të dhënë me koncesion.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta